



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

Nr. 888 prot

Lezhë, më 01.12.2020

VENDIM

Nr 49, Datë 01.12.2020

**“Për pezullimin e pjeshëm të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19”**

Bazuar në nenin 38 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, referuar vendimit nr.127 datë 10.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Vendimit nr.128 datë 24.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 143 datë 22.04.2020 “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”;

bazuar në Aktin Normativ nr.9 datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID 19”, neni 3 pika 3 dhe Udhëzimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr.146 datë 27.04.2020 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”;

**Këshilli i Gjykatës** pas diskutoi në mbledhjen urgjente të datës 01.12.2020 ora 13:00 mbi masat që duhet të ndërmerren për shkak të situatës së krijuar si rrjedhojë e infektimit me COVID 19 të kryesekretares të gjykatës, nisur nga natyra e punës së saj dhe kontakteve të shpeshta me personelin e administratës së gjykatës, dyshimet dhe nevojën për testime të personelit të gjykatës;

duke patur prioritet kryesor sigurinë e qytetarëve dhe të personelit të gjykatës, dhe nga ana tjetër detyrimin për ushtrimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore;

**VENDOSI:**

1. Pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë.
2. Përrjashtohen nga efektet e këtij pezullimi veprimtaria dhe shërbimet gjyqësore që lidhen me çështje të natyrës urgjente të përcaktuara në Aktin Normativ nr.9 datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID 19”, neni 3 pika 3.
3. Pezullimin nga kryesekretaria të veprimeve për komunikimin e vendimeve, shënimet e formës së prerë dhe përcjelljen e dosjeve gjyqësore në bazë ankimi në gjykatën më të lartë për të gjitha çështjet gjyqësore, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenin 3 pika 3 të Aktit normativ nr.9 datë 25.03.2020.
4. Ndërrprerjen e shortit elektronik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë gjatë periudhës së pezullimit. Kërkesat penale dhe civile me karakter të ngutshëm që depozitohen në



- gjykatë gjatë kësaj periudhe, do të shqyrtohen sipas urdhrimit të gadishmërisë të miratuar.
5. Kërkesat civile me karakter të ngutshëm apo kërkesëpaditë që përmbajnë kërkesa të tilla, që do të depozitohen gjatë periudhës së pezullimit, do të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem dhe vetëm kërkesa me karakter të ngutshëm do të shqyrtohet nga gjyqtari i gatshëm sipas urdhrimit të gadishmërisë. Me përfundimin e shqyrtimit të kërkesës me karakter të ngutshëm gjyqtari i gatshëm depoziton dosjen në sekretari dhe gjykimi i themelit i kalon gjyqtarit që do të caktohet me short elektronik.
  6. Të gjitha kërkesat/çështjet civile dhe penale që depozitohen nëpërmjet shërbimit postar gjatë kësaj periudhe, do të fillojnë të regjistrohen nga sekretaria gjyqësore në sistem në datë 14.12.2020 dhe do të hidhen në short në këtë datë.
  7. Orari i shërbimit për paraqitjen e kërkesave me karakter të ngutshëm nga publiku do të jetë nga ora 11:00-12:00 të çdo dite.
  8. Aksesimi në shërbime do të kryhet nëpërmjet komunikimit elektronik të bërë publike nga gjykata në ambientet në hyrje të saj, në faqen web të Gjykatës:  
- në adresat e e-mailit: [sekretaria.gjykatalezhe@gjykata.gov.al](mailto:sekretaria.gjykatalezhe@gjykata.gov.al) dhe [njoftime.gjykatalezhe@gjykata.gov.al](mailto:njoftime.gjykatalezhe@gjykata.gov.al), nëpërmjet shërbimit postar si dhe në numrat e kontaktit të sekretares regjistruese 0675281509 dhe sekretares gjyqësore 0685465317.
  9. Kohëzgjatja e pezullimit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë për një periudhë deri në datën 13.12.2020.
  10. Seancat gjyqësore të natyrës urgjente do të zhvillohen në sallën 1 dhe 2 të gjykatës të cilat sigurojnë më shumë hapësirë dhe distancë.
  11. Të sigurohet për aq sa është e mundur pjesëmarrja e palëve dhe pjesëmarrësve nëpërmjet lidhjes në distancë me videokonferencë. Në rast pamundësie të ndërlidhjes, palët ndërgjyqëse do të qëndrojnë në një sallë tjetër të gjykatës dhe do të marrin pjesë në seancë me videokonferencë.
  12. Në zhvillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, të përjashtuar nga efektet e pezullimit, të zbatohen masat e përcaktuara në Urdhërin nr.23 datë 10.03.2020 "Për marrjen e masave për sigurinë e qytetarëve dhe të personelit të gjykatës për shkak të situatës së krijuar nga COVID -19".
  13. Kancelarja e gjykatës të marrë masat për organizimin e punës dhe kryerjen e detyrave të natyrës urgjente nga nëpunësit e gjykatës sipas një grafiku gadishmërie.
  14. Punonjësit e tjerë do ta kryejnë punën në distancë për aq sa është e mundur, përveç kur kërkohet prezenca e tyre për detyra specifike që lidhen ngushtësisht me çështjet e natyrës urgjente.
  15. Ngarkohen punonjësit përgjegjës për marrjen e masave organizative dhe kryerjen e procedurave përkatëse për dezinfektimin e ambienteve të gjykatës.
  16. Nëpunësi IT të marrë masa për afishimin e njoftimit mbi vendimarrjen e Këshillit të Gjykatës në këndin e njoftimeve dhe faqen zyrtare të gjykatës në internet. Nëpunësi IT të marra masa lidhur me njoftimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë lidhur me kategorinë e çështjeve penale të pezulluara.
  17. Nëpunësi IT të marrë masa për njoftimin menjëherë të IEVP-ve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për kategorinë e çështjeve dhe seancat gjyqësore konkrete të planifikuara, të cilat pezullohen dhe për rrjedhim shoqërimi i të paraburgosurve/të dënuarve apo ndërlidhja audiovizive në distancë nuk është e nevojshme.
  18. Nëpunësi IT të komunikojë me IEVP-të dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për marrjen e masave për të siguruar ndërlidhje audiovizive në distancë.
  19. Ngarkohet kancelarja e gjykatës me mbikqyrjen e zbatimit të këtij urdhëri.
  20. Ky vendim t'i komunikohet menjëherë Këshillit të Lartë Gjyqësor.
  21. Një kopje e këtij urdhëri t'i komunikohet gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore.



22. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE E GJYKATËS**  
**Ornela NAQELLARI**

**Zv/KRYETARE E GJYKATËS**  
**Elsa ULLIRI**

**KANCELARE E GJYKATËS**  
**Ardiana KRASNIQI**



[shqiptarja.com]